



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:169595

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05454892

*P.nr.1006/2023*

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtari i vetem gjykues Fatmir Krasniqi me sekretetaren juridike Fatime Bjaraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarit **E.T.**, nga Prizreni, dhe mbrojtësit të tij **av.B.M.**, nga Prizreni, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 par.3 nën par.3.2 lidhur me par.2 të KP-se, dhe veprës penale kanosje nga neni 181 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore të shtetit në Prizren PP/II.nr.1308-4/23 të datës.29.09.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurorit Themelor të Shtetit Merita Gaka, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, të demtuarit, me datë 29.02.2024, morri dhe shpalli publikisht këtë:

## AKT GJYKIM

**E.T.**, nga i ati ....., e ëma ....., e vajzerise ....., i lindur më datë .....në Prizren, ku edhe tani jeton, ne Rr. ....banesa ....., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, kamarier, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal .....

## ËSHTË FAJTOR

1.Se me dt.20.06.2023, rreth orës 12:10min, në rr.”Hysen Kabashi” në Prizren, saktësisht në banesën e përbashkët familjare, i pandehuri E.T., me dashje përdor forcën ndaj të dëmtuarit Z.Q., respektivisht babait të tij, viktimë e ndjeshme për shkak të marrëdhënieve familjare, në atë mënyrë që ditën kritike pas një mosmarrëveshje dhe konflikti verbal mes tyre për shkak se i pandehuri ia kishte marr automjetin të dëmtuarit pa lejen e tij, aty për një moment eskalon situata ashtu që i pandehuri në gjendje të nervozuar e sulmon të dëmtuarin ku fillimisht me forcë e hap derën te cilën e kishte mbyllur i dëmtuari dhe me pas me një mjet të mprehtë – thikë e godet ne krahun e majtë, me të cilat veprime tek i dëmtuari

Z.Q., shkaktuar gërvishtje në dorën e majtë por që i njëjti refuzon tretmanin mjekësor,

**-Me këto veprime ka kryer veprën penale: Sulmi nga neni 184 par. 3 nënpar.3.2 lidhur me par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.**

2. Me datë 20.06.2023 rreth orës 12:45min, në Prizren, i pandehuri E.T., përmes telefonit seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë se do se do ta privojë dhe atë të dëmtuarin Z. Q., respektivisht babain e tij, në atë mënyrë që si rrjedhojë e një mosmarrëveshje mes tyre e për të cilin rast i dëmtuari e kishte lajmëruar rastin në polici ashtu që gjate dhënies se deklaratës në polici i dëmtuari pranon dy mesazhe - sms nga i pandehuri me përmbajtje kërcënuese me fjalët se: “veq tshoh tu hi nbanes ka met vra, sa tje gjall pa tvra unë nuk lajmërohem te veni”, me ç’rast me këto veprime tek i dëmtuari Z. Q., ka shkaktuar frikë, ankth dhe pasiguri për jetë.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 69, 70, 71, 72 nenit 184 par.3 nën 3.2 lidhur me par.2, nenit 181 par.2 të KPK-ës e nenit 364 të KPPK-ës, të akuzuarit i shqipton:

## **DËNIM ME BURGIM**

Për veprën penale nën I të dispozitivit të kësaj aktakuze në kohëzgjatje prej **6 /gjashtë/ muajve**, i cili denim me burgim do te ekzekutohet pas plotefuqishmerise se ketije aktgjykimi.

Për veprën penale nën II të dispozitivit të kësaj aktakuze në kohëzgjatje prej **6 /gjashtë/ muajve**, i cili denim me burgim do te ekzekutohet pas plotefuqishmerise se ketije aktgjykimi.

Gjykata koform nenit 76 par.1 dhe 2 nenpar.2.3 te KP-së të akuzuarit i shqipton dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej **1o (dhjetë) muajve**, i cili denim me burgim do te ekzekutohet pas plotefuqishmerise se ketije aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari që të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor shumë prej **20.00 euro**, dhe në emër të kompensimit për viktimat e krimit shumë prej **20.00 euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotefuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën me PP/II.nr.1308-4/2023 të datës.29.09.2023, kundër te akuzuarit E.T., nga Prizreni, per shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 par.3 nën par.3.2 lidhur me par.2 te KP-se, dhe veprës penale kanosje nga neni 181 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Gjykata në shqyrtimin fillestar gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjatë pranimit të fajësisë gjykata konstatoi se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezentuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me kohë në pajtim me nenin 242 par.1 e 2 nën par.2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPK-së, ku nga të cekurat më lartë gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të veprës penale sulmi nga neni 184 par.3 nën par.3.2 lidhur me par.2 të KP-se, dhe veprës penale kanosje nga neni 181 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me burgim, duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penale juridike

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPK-se të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethana rënduese gjykata mori për bazë dashjen, shkallen e përgjegjëse penale, motivet për kryerjen e ketyre veprave penale, intezitetin e rrezikimit dhe demtimin të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, vepra penale është kryer ndaj të demtuarit viktime e ndijeshme-babit të tije, i akuzuari është perserites-recidivist i veprave penale dhe atë me P.nr.1148/2021, Gjykata Themelore Prizren, vepra penakle e mashtrimit nga neni 323 par.1 të KP-se, i plotefuqishem me dt.22.10.2022, P.nr.121/2022, Gjykata Themelore në Prizren, vepra penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 267 par.1 të KP-se, i plotefuqishem me dt.23.02.2023, e si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, pranimi ka qenë i vullnetshëm, pa presion e as pa ndikim nga jashtë, në kuptim të nenit 70, 71, 72 KPK-së gjykata morri bazë edhe bashkëpunimin e të akuzuarit me gjykatën ky bashkëpunim ka të bëjë me hetimin dhe ndjekjen penale edhe të kryesve tjerë të veprave penale, po ashtu gjykata morri për bazë qëndrimin korrekt të akuzuarit ndaj gjykatës, në një formë pendimi i tij për kryerjen e veprave penale, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me burgim, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jete me i kujdesshem, dhe të përmbahet nga veprimet e tilla të karakterit penalo-juridik.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 454 të KPPK-së.

Vendimin mbi kompensimin e viktimave të Krimit, gjykata e mori në kuptim të nenit 39 para.3 pika 1 të Ligjit me numër 05/L-036.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i pergjithshem penal**  
**P.nr.1006/2023 të datës 29.02.2024**

**Sekretare juridike**  
**Fatime Bajraktari**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Fatmir Krasniqi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditëve pas pranimit të së njëjtës, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.